



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:063255

Datë: 23.10.2019

Numri i dokumentit: 00596409

P.nr.795/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Mandushe Doli – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit P.R., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, me numër PP/II.nr.1459/2018, të datës 12.11.2018, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur **me datën 22.10.2019**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Enis Gashi, të dëmtuarit Gj.R., të akuzuarit si dhe mbrojtësit të tij av.N.D. nga Gjakova, në të njëjtën ditë mori, ndërsa me datën 23.10.2019 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

P.R., nga i ati Z., e ëma K., e gjinisë L., data e lindjes..., , Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon, i martuar, baba i tre (3) fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal...

Në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar 1.1 të KPP-së,

REFUZOHET AKUZA

Sepse me datën 27.09.2018, rreth orës 17:00 minuta, në fshatin B. Komuna e Gjakovës, saktësisht në lagjen e tyre, e kanoste seriozisht të dëmtuarit Gj.R., në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duk ecur rrugës së lagjes me bashkëshorten e tij, aty kishte ardhur i akuzuari me veturë me shpejtësi të madhe në drejtim të dëmtuarit dhe bashkëshortes së tij, i dëmtuari duke mos e ditur se kush është i drejtohet me fjalë “lëviz më ngadalë”, aty për momentin ndalet i akuzuari dhe më pas del nga vetura i drejtohet të dëmtuarit me fjalë kërcënuese “thirre policinë për këtë, më mos më ndal më se të bëj copa copa” deri sa ndërhyjnë vajzat e të akuzuarit dhe e ndalin dhe e fusin në veturë, me ç’rast tek i dëmtuari shkakton frikë dhe ankth.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së.

Për shkak të tërheqjes së prokurorit të shtetit nga akuza gjatë shqyrtimit fillestar.

Shpenzimet e procedurës penale bijën në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.1459/2018, të datës 12.11.2018, kundër të akuzuarit P.R., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së.

I dëmtuari Gj.R. gjatë shqyrtimit fillestar, pasi që i akuzuari P.R. e kishe pranuar fajësinë duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit është tërhequr nga ndjeka penale duke deklaruar se: nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit por si i dëmtuar për këtë rast nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike, nuk kërkoi kompensim dëmi për veprën penale, e vlerësoj pranimin e fajësisë nga ana e këtu të akuzuarit, mirëpo meqenëse i akuzuari gjatë kësaj seance ka kërkuar falje publike dhe ka premtuar se nuk do të përsërisë veprime të këtilla si dhe duke marrë për bazë faktin se me të njëjtin jemi fqinjë- kushërinj, jetojmë në të njëjtin fshati-në një rrugë, dhe nuk kemi asgjë të keqe, por që kërkoi që në të ardhmen mos të përsëriten këso veprime, si i dëmtuar deklarojë se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk kërkoi që i njëjti të dënohet për veprën penale meqenëse ia pranoi edhe kërkim faljen.

Në seancën publike të shqyrtimit fillestar të datës 22.10.2019, Prokurori i Shtetit Enis Gashi është tërhequr nga ndjeka penale dhe akuza kundër të akuzuarit P.R., Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së, duke deklaruar pas dëgjimit të palës së dëmtuar i cili deklaroi se në rastin konkret ndaj të akuzuarit nuk i bashkëngjitet ndjekje penale, pasi me të njëjtin i kanë rregulluar raportet, e duke marrë për bazë se vepra penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së, fillohet respektivisht ndiqet sipas propozimit të palës së dëmtuar e pasi që në rastin konkret pas deklarimit të dëmtuarit mungon propozimi për ndjekje penale ndaj të akuzuarit, kështu që duke u mbështetur në nenin 185 par. 5 të KPRK-së, tërhiqem nga ndjekja penale dhe aktakuza kundër të akuzuarit P.R. për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par. 1 të KPRK-së i akuzuar sipas aktakuzës PP/II nr. 1459/18 dt. 12.11.2018.

Duke pas parasysh se në seancën publike të shqyrtimit fillestar Prokurori i Shtetit është tërhequr nga aktakuza kundër të akuzuarit P.R., Komuna-Gjakovë, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së, gjykata në kuptim të dispozitës të nenit 363 par.1 nënpar 1.1 të KPP mori aktgjykim refuzues në këtë çështje penale dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të paraparë me këtë dispozitë ligjore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mur në kuptim të nenit 454 par.1 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

- Departamenti i Përgjithshëm -
P.nr.795/2018, më datë 22.10.2019

Procesmbajtësja,
Mandushe Doli

Gjyqtari i vetëm gjykses,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.